

Në mbështetje të nenit 69. të Statutit të komunës Preshevë („Fl.zyrtare e Rrethit të Pçinjës“, nr. 6/21), nenit 2. Vendimit mbi Këshillin komunal të komunës Preshevë („Fl.zyrtare e Rrethit të Pçinjës“, nr. 31/08), („Fl.zyrtare e Qytetit të Leskocit“, nr.17/2011), („Fl.zyrtare e Qytetit të Vranjës“, nr. 26/13), („Fl.zyrtare e Komunës së Bujanocit“, nr.7/13), pas shqyrtimit të pikës së rendit të ditës për Anulimin e Vendimit mbi ndarjen e mjeteve organizatave joqeveritare për vitin 2021 , në propozim të komisionit të themeluar nga Këshilli Komunal , Këshilli komunal i komunës Preshevë, në mbledhjen e vetë të mbajtur më 15.06.2021 nxorri këtë:

V ENDIM

mbi anulimin e Vendimit për zgjedhjen e përfituesve të programit për OJQ II.nr.023-1 të datës 12.04.2021

I.

ANULOHEK Vendimi për përzgjedhjen e përfituesve të programit për OJQ II.nr.023-1 të datës 12.04.2021 .

II.

Urdhërohet drejtorati për veprimtari shoqërore që të zbatojë procedurën e shkëputjes së kontratave të veçanta me OJQ-të përfituese të konkursit.

III.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Arsyetim

Këshilli Komunal i komunës së Preshevës shqyrtoi Vendimin për zgjedhjen e përfituesve të programit për OJQ II.nr.023-1 të datës 12.04.2021.

Komisioni i formuar nga Këshilli Komunal gjatë shqyrtimit të Vendimit të Organit të Organit të përkohshëm të datës 12.04.2021 hasi në parregullsi ku në bazë të të dhënave rreth financimit të organizatave del se dy nga ato organizata janë shpërblyer me shuma të mëdha njëra me 760.000,00 din , dhe tjetra 1,460,000,00 din , sa që janë paraparë me konkurs , që sipas konkursit dhe rregullores nuk duhet të jetë më e lartë se 300.000,00 din.

Në bazë të fakteve të cilat komisioni i ka gjetur dhe moszbatimit të kriterëve dhe mënyrës së ndarjes së mjeteve i propozon Këshillit Komunal të anulojë Vendimin dhe kontratat.

Këshilli Komunal i komunës së Preshevës në bazë të propozimit të komisionit vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:Përfituesve të programit ,Drejtoratit për Buxhet financa dhe prokurime publike, Drejtoratit për veprimtari shoqërore , Këshillit komunal dhe Arkivit.

KËSHILLI KOMUNAL I KOMUNËS PRESHEVË

III .Nr.023-2/2021

**Kryetare
Ardita Sinani**

